

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Driton Muharremi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.Z. nga fsh. Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasja në tentativë nga neni 25 lidhur me nenin 146 dhe nenin 20 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.61/12, të datës 19.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 03 maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar**, ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.61/12, të datës 19.01.2018, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.61/12, të datës 19.01.2018, i akuzuari A.Z. , në mungesë të provave, e në bazë të nenit 364 par.1 nen par.1.3 të KPPRK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasja në tentativë nga neni 25 lidhur me nenin 146 dhe nenin 20 të KPPRK-së,. Sa i përket shpenzimeve të procedurës penale lidhur me këtë çështje juridiko-penale është vendosur që të njëjtat të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale , vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan ta anulojë dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykimi dhe vendosje.

Gjithashtu përgjigje në ankesë kanë paparaqitur mbrojtësit e të akuzuarit A.Z. , av. R.A. , nga Gjilani me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, me shkresën e vet PPA.l.nr.139/18, të datës 30.03.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës

Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk është e bazuar.

Prokuroria Themelore në Gjilan, sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me ankesë pretendon se ky aktgjykim është i përfshirë në shkelje nga nenin 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPRK-së, duke pretenduar se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, është kundërtënë me gjendjen faktike apo me faktet vendimtare të cilat janë prezantuar në arsyetim të aktgjykimit dhe nuk kanë lidhshmëri me dispozitivin ashtu që e bëjnë të pa qartë aktgjykimin si tërësi. Gjithashtu shton se gabimisht është bërë kualifikimi juridik kur është liruar nga akuza për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasja në tentativë nga neni 25 lidhur me nenin 146 dhe nenin 20 të KPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se pretendimet e mësipërme ankimore lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, nuk përmban kundërtënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetim janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në harmoni me nenin 370 të KPPRK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të paprovuara. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të tyre ka nxjerrë konkludimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjithashtu, nuk ekzistojnë as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Sa i përket pretendimit ankimor se i akuzuari ka qenë i akuzuar për të veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasja në tentativë nga neni 25 lidhur me nenin 146 dhe nenin 20 të KPK-së, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka bërë gabimisht kualifikimin duke konstatuar nenin 147 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, sipas Gjykatës së Apelit në rastin konkret nuk kemi të bëjnë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale por vetëm në një gabim teknik në numra ngase edhe gjykata kur ka nxjerre aktgjykim lirues ka konstatuar se i akuzuari është liruar nga akuza për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasje në tentativë e jo ndihma në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, por, gabimisht është shënuar në vend të nenin 146 , neni 147 të KPK-së.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan theksohet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarin A.Z. e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasja në tentativë nga neni 25 lidhur me nenin 146 dhe nenin 20 të KPK-së. Sipas Prokurorisë me rastin e marrjes së aktgjykimit, gjykata e

shkallës së parë ka qenë e njëanshme duke i'a falur besimin deklaratës së të akuzuarit A.Z. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor pa pasur prova të argumentuara, edhe për kundër faktit se gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të qartë është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale dhe se në veprimet e tij janë plotësuar elementet e veprës penale për të cilën ka qenë i akuzuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konstaton se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk janë të bazuara dhe se gjendjen e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë e aprovon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës. Gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimin gjyqësor pas dëgjimit të akuzuarit A.Z. dhe pas administrimit të provave, dëgjimit të dëshmitarëve M.T. , N.A. , A.Z. dhe E.R. , ka vërtetuar se i akuzuari A.Z. ditën kritike deri sa ka qenë duke pirë kafe në kafiterinë "...” e cila gjendet në Viti, dhe pas kësaj është nisur në drejtim të stacionit të autobusëve dhe tek xhamia e qytetit ka dëgjuar se janë rrahur disa persona të fshatit Ballance në mes veti dhe në ato momente e ka parë vllaun e tij Xh.Z. e cili kishte treguar se ishte rrahur me A. dhe menjëherë kanë marrë një taxi dhe janë nisur së bashku për të shkuar në shtëpi. Në shtëpi Xh.Z. i kishte treguar se e ka gjuajtur thikën, mirëpo A.Z. i nuk e kishte vërejtur që është gjuajtur diçka nga vetura. Pra, nuk e ka parë të arsyeshme ta paraqes rastin në polici. Pra gjykata e shkallës së parë me asnjë provë nuk ka arritur që ta vërtetoj se i akuzuari A.Z. , ta ketë ndihmuar apo ti ketë dhënë në dispozicion ndonjë mjet apo ti ketë krijuar kushte për kryerjen e veprës penale, ngase kjo nuk është vërtetuar me deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor.

Këte gjendje faktike të vërtetuara nga Gjykata Themelore e aprovon edhe Gjykata e Apelit, nga arsyeja se nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari A.Z. ta ketë ndihmuar vllaun e tij Xh.Z., në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentative me datë 21.10.2011, në stacionin e autobusëve në Viti, me çrast janë shkaktuar lëndime të rënda trupore me thikë të dëmtuarit A.N. .

Nga kjo del se nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin A.Z. n në mungesë të provave e ka liruar nga akuza për veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.144/18. Më 03.05.2018

Procesmbajtës
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Driton Muharremi